

Në bazë të nenit 147 dhe 148 të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Ulqinit („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 27/20, Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më ____ . ____ . 2022 ka miratuar

P R O G R A M I N

e punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit për vitin 2022, tremujori i IV

Me programin e punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit për vitin 2022 përcaktohen punët dhe detyrat e Kuvendit të Komunës dhe përmbajtjet e tyre themelore, bartësit e punëve dhe afatet e shqyrtimit të çështjeve të caktuara.

I. MATERIALI INFORMATIV – ANALITIK

(raporti i punës, raportet nga fusha të caktuara administrative dhe informatat e punës)

Kryetari dhe Sekretari i Kuvendit janë të detyruar të përcjellin aktivitetin në realizimin e këtij Programi, si dhe të marrin përsipër masat e nevojshme për realizimin e plotë dhe në kohë

TREMUJORI I – IV

- 1. Informatë për gjendjen e rregullimit të hapësirës për vitin 2021**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Sekretariati për planifikim të hapësirës dhe zhvillim të qëndrueshëm/Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesore
Afati: Tremujori i IV
- 2. Raporti dhe analiza e gjendjes në ekonomi**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik
Afati: Tremujori i IV
- 3. Raporti dhe analiza e gjendjes në bujqësi në Komunën e Ulqinit dhe shfrytëzimi i mjeteve të Buxhetit të Malit të Zi për vitin 2021**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Sekretariati për bujqësi, zhvillim rural dhe ekologji /Këshilltari për bujqësi
Afati: Tremujori i IV
- 4. Informatë për realizimin e vendimeve të komunës dhe dokumenteve të planifikimit lokal**
Propozues: Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Kuvendit
Përpunues: Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Shërbimi i Kuvendit
Afati: Tremujori i IV

II. VEPRIMTARIA NORMATIVE

TREMUJORI I IV

- 1. Propozim Vendimi për miratimin e programit trevjeçar të përmirësimit të efikasitetit energjetik**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesore
Afati: Tremujori i III

2. Miratimi i vendimit për themelimin (organizimin) e institucioneve publike nga fusha e kulturës. (Riorganizimi i mëtejshëm institucional i NP „Qendra për kulturë“ Ulqin)

Propozues: Kryetari i Komunës

Përpunues: Sekretariati për kulturë, sport, të rinj dhe veprimtari shoqërore

Afati: Tremujori i IV

3. Miratimi i vendimit për themelimin (organizimin) e SHPK „Park natyror – Sollana e Ulqinit”.

Përpunues: Kryetari i komunës

Propozues: Sekretarijati për veprimtari komunale dhe çështje banesore

Afati: Tremujori i IV

4. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2023

Përpunues: Sekretariati për financa dhe buxhet

Propozues: Kryetari i Komunës

Afati: Tremujori i IV

**III. PLANIFIKIMI DHE PROGRAMIMI
TREMUJORI I – IV**

1. Propozim i planit menaxhues të të mirave të mbrojtura natyrore në Komunën e Ulqinit

Propozues: Kryetari i Komunës

Propozues: Sekretariati për veprimtari komunale e banesore

Afati: Tremujori i III

2. Plani i rregullimit të hapësirës për vitin 2023

Propozues: Kryetari i Komunës

Përpunues: Sekretariati për planifikimin e hapësirës dhe zhvillim të qëndrueshëm

Afati: Tremujori i IV

3. Plani i zhvillimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve komunale dhe të pakategorizuara për vitin 2023

Propozues: Kryetari i Komunës

Përpunues: Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesore

Afati: Tremujori IV

4. Plani dhe Programi i punës së SHPK „Veprimtaritë komunale“ për vitin 2023

Propozues: Kryetari i Komunës / Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesore / SHPK „Veprimtaritë komunale“ Ulqin

Afati: Tremujori IV

5. Plani dhe Programi i punës së SHPK „Ujësjetësi e kanalizimi“ për vitin 2023

Propozues: Kryetari i Komunës / Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesore / SHPK „Ujësjetësi e kanalizimi“ Ulqin

Afati: Tremujori IV

6. Plani dhe programi i punës i Qendrës për kulturë për vitin 2023

Propozues: Kryetari i Komunës/ Sekretariati për kulturë, sport, të rinj dhe veprimtari shoqërore

Përpunues: Qendra për kulturë

Afati: Tremujori IV

7. **Plani dhe programi i punës i SHPK „Për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, zhvillimin dhe gjuetisë së egërsirave dhe peshkim“ Ulcinj për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: SHPK „Për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, zhvillimin dhe gjuetisë së egërsirave dhe peshkim“ Ulcinj
Afati: tremujori IV
8. **Plani dhe programi i punës i Agjencisë për ndërtim dhe zhvillim për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës/Sekretariati për planifikim të hapësirës dhe zhvillim të qëndrueshëm
Përpunues: Agjencia për zhvillimin dhe ndërtimin e Ulqinit
Afati: Tremujori IV
9. **Plani dhe programi i punës i NP „Qendra ditore për fëmijë dhe të rinj me pengesa në zhvillim Sirena“ për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: NP Qendra ditore për fëmijë dhe të rinj me pengesa dhe vështirësi në zhvillim „Sirena“ Ulqin
Afati: Tremujori IV
10. **Plani dhe programi i punës i SHPK „RTUL“ për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: SHPK „RTUL“ Ulqin
Afati: Tremujori IV
11. **Plani dhe Programi i punës së SHPK „Parking servisi“ për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Drejtori SHPK „Parking servisi“
Afati: Tremujori IV
12. **Plani dhe Programi i punës së SHPK „Mozhura“ për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Drejtori SHPK „Mozhura“
Afati: Tremujori IV
13. **Plani dhe programi i Organizatës turistike Ulqin për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Organizata turistike
Afati: Tremujori IV
14. **Programi social për gra dhe fëmijë të braktisur (neglizhuar)**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore
Afati: Tremujori IV
15. **Plani dhe Programi i punës së SHPK „Vodacom“ për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Drejtori i SHPK „Vodacom“
16. **Plani strategjik i zhvillimit të Komunës së Ulqinit për periudhën 2022-2028**
Propozues: Kryetari i Komunës
Përpunues: Kryetari i Komunës
Afati: Tremujori IV
17. **Programi i punës së Kuvendit për vitin 2023**
Propozues: Kryetari i Kuvendit
Përpunues: Shërbimi i Kuvendit

Afati: Tremujori IV

Kuvendi gjatë periudhës programore do të shqyrtojë edhe çështje të tjera nga kompetencat e veta për të cilat do të paraqitet nevoja për shkak të ndryshimeve eventuale të ligjeve, me qëllim të harmonizimit të vendimeve të komunës dhe akteve të tjerë me zgjidhjet e reja ligjore.

Gjatë periudhës programore, Kuvendi shqyrton dhe miraton akte administrative individuale lidhur me disponimin e pasurisë, si dhe akte të dala nga puna e këshillit për zgjedhje dhe emërimë, të cilat kanë statusin e akteve individuale.

Ky program hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në „Fletën zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës“.

Numër: 02-____/22

Ulqin, më ____ . ____ . 2022

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

KRYETARI

Ardijan Mavriq

A r s y e t i m

Baza juridike për miratimin e Programit është në nenin 147 dhe 148 të Rregullores së Kuvendit me të cilët parashikohet që Programi i punës miratohet për vitin kalendarik. Pasi që ka qenë vit i zgjedhjeve Kuvendi nuk e ka miratuar Programin e punës për vitin kalendarik edhe pse materiali është përgatitur në tremujorin e I-ë të vitit aktual.

Arsyet për të cilat propozohet miratimi i Programit për tremujorin e IV janë në faktin se me Program janë përcaktuar obligimet ligjore dhe statutore të organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike për përgatitjen e programit, Buxhetit dhe akteve të tjerë deri në fund të vitit aktual.

Për zbatimin e Programit do të kujdeset Shërbimi i Kuvendit e Programi do të publikohet në Fletën zyrtare – dispozitat e komunës.

Shërbimi i Kuvendit